



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI
KOMISIONI PËR SIGURINË KOMBËTARE**

Tiranë më 17.12.2018
Dokument parlamentar

R A P O R T

Mbi projektligjin *“Për një shtesë në ligjin nr.8328, datë 16.4.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve”, të ndryshuar”*

Drejtuar: Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, bazuar në nenet 32-36 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi shqyrtoi në mbledhjet e datës 11.12.2018 dhe 17.12.2018 në parim, nen për nen dhe në tërësi, projektligjin *“Për një shtesë në ligjin nr.8328, datë 16.4.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve”, të ndryshuar”*.

I. Qëllimi dhe objektivi i projektligjit:

Projektligji, i cili ndryshon Ligjin Nr. 8328, i datës 16.4.1998, *“Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim dhe të Paraburgosurve, i ndryshuar”*, propozon një Regjim të Posaçëm për të dënuarit me burgim, të ndaluar në një burg të sigurisë së lartë.

Qëllimi i këtij projektligji është rritja e masave të sigurisë dhe të drejtave të të dënuarve e të paraburgosurve për raste të veçanta, duke iu nënshtruar një regjimi të posaçëm të ushtrimit të të drejtave, i cili do t'i kufizonte të burgosurit të kontaktonin me njëri-tjetrin ose të komunikonin me botën e jashtme.

II. DISKUTIME NË KOMISIONIN E SIGURISË KOMBËTARE

Për prezantimin e projektligjit në komision ishin të pranishëm Ministre e Drejtësisë Znj.Etilda Gjonaj, Zvendësministre e Drejtësisë Znj.Teuta Vodo,

Zvendësministri i Brendshëm Z.Julian Hodaj, Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve Z.Stefan Çipa së bashku me stafet respektive.

Znj.Gjonaj u shpreh se lufta kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit mbetet një nga prioritetet e qeverisë shqiptare dhe njëkohësisht është një nga detyrimet kryesore që rrjedhin nga procesi i intergrimit në Bashkim European. Kjo luftë është ashpërsuar më tej dhe masat e qeverisë janë bërë më efikase gjatë vitit të fundit veçanërisht më një sërë inicativash siç është edhe operacioni Forca e Ligjit.

Ajo u shpreh se nga puna operative e strukturave të policisë në burgje, por edhe nga strukturat e policisë së shtetit, është konstatuar se elementët kriminalë ndonëse të izoluar në burgje, kanë tendencën që të vijojnë të ruajnë lidhjet me bashkëpunëtorët e organizatave të tyre kriminale apo organizatave të tjera.

Mandej znj.Gjonaj u shpreh se qëllimi i projektligjit është pikërisht rritja e masave të sigurisë dhe kufizimi i disa të drejtave të dënuarve dhe të paraburgosurve për raste të veçanta që lidhen me krimin e organizuar duke iu nënshtruar një regjimi të posaçëm brenda sistemit të sigurisë së lartë.

Masat e ndërmarra në kuadër të zbatimit të këtij regjimi janë të ngjashme me masat e parashikuara në nenin 41 bis të sistemit italian. Prokuroria e Antimafias Italiane e ka vlerësuar jashtëzakonisht përfshirjen e këtij parashikimi të ri ligjor dhe zbatimin e këtij regjimi të kufizuar brenda burgjeve të sigurisë së lartë, gjithmonë në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar.

Gjithashtu, Znj.Gjonaj theksoi se mënyra e zbatimit të këtyre masave në realitetin shqiptar është ndryshe nga zbatimi i praktikës italiane por megjithatë ky propozim është studiuar edhe nga drejtoritë përkatëse në Ministrinë e Drejtësisë dhe është në përputhje me Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe jurisprudencën e saj, ku sipas tyre të tilla masa duhet të ndërmerren vetëm në situata emergjente, vetëm nëpërmjet dispozitave të parashikuara qartë, sikundër janë ato të parashikuara në projektligjin e propozuar dhe për një kohëzgjatje të caktuar.

Konkretisht neni i propozuar nga Ministria e Drejtësisë parashikon:

Në paragrafin e parë është bërë një përcaktim i saktë i neneve për të cilat duhet të zbatohet ky regjim i posaçëm. Këto nene dënojnë jo vetëm krijimin dhe pjesëmarrjen në një organizatë kriminale, organizatë terroriste, bandë të armatosur ose grup të strukturuar kriminal por edhe veprat penale të kryera nga anëtarët e krimit të organizuar në kuadër të përmbushjes së qëllimeve të veprimtarisë së tyre kriminale. Më pas, po në këtë paragraf, janë parashikuar një sërë masash që duhet të ndërmerren edhe ndaj të dënuarve dhe ndaj të paraburgosurve që hetohen apo gjykohen për këto vepra penale.

Përcaktimi i këtyre masave është bazuar në nenin 41 bis të ligjit italian për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve. Ky nen është marrë në shqyrtim disa herë edhe nga GJEDNJ-ja dhe është cilësuar për mënyrën e zbatimit të tij në përputhje me orientimet e KEDNJ-së dhe të vetë GJEDNJ-së.

Sipas këtyre orientimeve, kufizime të tilla të të drejtave duhet të ndërmerren vetëm për situata emergjente dhe të kenë një kohëzgjatje të përcaktuar, pas së cilës mund të rivlerësohen kushtet dhe kriteret për zbatimin e këtij regjimi.

Nëse një person do të arrestohet dhe do të gjykohet për këto vepra penale, ai duhet të vendoset në një regjim të posaçëm me kufizim të të drejtave, me qëllimin për të të parandaluar:

- a) kontaktet me organizatën kriminale ku bën pjesë apo me organizata të tjera aleate;
- b) konfliktet e mundshme me elementë të organizatave kundërshtarë;
- c) ndërveprimin me të burgosurit apo të paraburgosurit e tjerë, që i përkasin të njëjtës organizatë ose të organizatave të tjera me të cilat ata bashkëpunojnë.

Kjo periudhë nuk mund të jetë më e gjatë se 1 vit. Për këtë arsye, edhe në përputhje me orientimet e GJEDNJ-së, është përcaktuar e drejta e ministrit të Drejtësisë, që, më kërkesë të të dënuarit apo të paraburgosurit, të bëjë një rivlerësim të kushteve për vazhdimësinë e këtij regjimi të posaçëm.

Në projektligj janë parashikuar edhe kriteret se ku duhet të bazohet vendimi i Ministrit të Drejtësisë për rivlerësimin e situatës. Pas rivlerësimit të kushteve dhe urdhrin të ministrit të Drejtësisë për vazhdimin e këtij regjimi të posaçëm për një periudhë tjetër 1-vjeçare, i dënuari, i paraburgosuri apo avokati mbrojtës kanë të drejtë të bëjnë ankim në gjykatë, nëse e shikojnë të arsyeshme.

Relatori i projektligjit z.Pjerin Ndreu, u shpreh se për sa kohë kemi të bëjmë me një kategori të dënuarish ose të paraburgosurish për vepra tepër të rënda dhe që kanë të bëjnë me pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë të armatosur, organizatë terroriste apo për vepra me qëllime terroriste që kanë rrezikshmëri të lartë shoqërore, këta persona duhet t'i nënshtrohen një regjimi të posaçëm të ushtrimit të të drejtave. Ai theksoi se vlerëson qëllimin e projektligjit por modalitetit duhet të rishikohen.

Nga diskutimet dhe pyetjet e shtruara në Komision u evidentuan disa problematika si më poshtë:

Në qëllim e gjitha duket logjike dhe është një vlerë e shtuar në luftën kundër krimit të organizuar por duhen vendosur edhe ato instrumente që sigurojnë balancën nëpërmjet qëllimit, nevojës dhe respektit të lirive dhe të drejtave të njeriut.

Duhet patur paraprakisht një analizë se sa është numri i personave të përfshirë në krimin e organizuar, që edhe pse të dënuar kanë ndikuar në kryerjen e veprave të tjera penale jashtë, pra një statistikë rreth recidivizmit për krimet e rënda, një analizë e detajuar rreth shkallës së përhapjes dhe rrezikshmërisë së këtij fenomeni.

Për nga mënyra se si është shkruar, duket sikur të gjithë të dënuarit që vendosen në burgun e sigurisë së lartë, të dënuar për vepra penale të parashikuara në projektligj, duhet të kalojnë automatikisht në regjimin e posaçëm. Sipas ligjit për trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve është gjykata ajo që vendos regjimin e burgut. Në momentin që në ligj përdoret shprehja “vendos në burgun e sigurisë së lartë” për veprat e parashikuara në projektligj lind pyetja nëse të gjithë automatikisht do kalojnë në regjimin e posaçëm apo ndërmjet tyre do veçohen njerëz që kanë prirje për të vijuar aktivitetin kriminal nga brenda burgut.

Në burgun e sigurisë së lartë nuk shkojnë vetëm ata që kryejnë vepra penale të terrorizmit , të grupit të organizuar kriminal etj., po shkon edhe ai që kryen psh. një vrasje për gjakmarrje, sepse për shkak të rrezikshmërisë shoqërore të lartë që ai paraqet, gjykata, edhe sipas kërkesës dhe të dhënave që i vë në dispozicion prokurori, çmon që ky duhet të shkojë në burgun e sigurisë së lartë. Kështu siç ka ardhur propozimi , natyrisht që kjo kategori nuk duhet të futet në regjimin e posaçëm të burgut të sigurisë së lartë, por siç është shkruar propozimi, i bie që pavarësisht që personi paraqet të dhëna për rrezikshmëria apo jo, mjafton që të jetë i dënuar për një nga veprat penale të parashikuara në projektligj, ai automatikisht duhet të kalojë në regjimin e posaçëm të burgut të sigurisë së lartë.

Një tjetër problematikë lidhet me faktin se kur Ministri i Drejtësisë do të vendosë revokimin apo jo të regjimit, ka të nevojshëm më shumë mendimin e Ministrit të Brendshëm apo Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit? Futja në lojë e të dy ministrave, Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Brendshëm, e politizon shumë çështjen për marrjen e një vendimi të tillë. ndërkohë që mund të përfshihet Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit nisur edhe nga informacioni që ai disponon për lidhjet jashtë edhe brenda të një personi të dënuar.

Çështje tjetër, ishte nëse në vlerësimin që bën Ministri i Drejtësisë që një person të vijojë në regjimin e posaçëm i dënuar ose i paraburgosur, duhet të marri apo jo mendimin e Prokurorit të Prokurorisë së Posaçme, pasi tanimë kjo prokurori së shpejti do krijohet dhe nuk mbulon vetëm akuzat që lidhen me zyrtarët e lartë por të gjitha veprat penale që lidhen me krimin e organizuar pavarësisht nga vendi i ndodhjes së veprës, apo vendbanimi i atij që kryen veprën.

Për projektligjin është shprehur edhe EURALIUS i cili thekson se:

Neni 13/1 parashikon zbatimin e menjëhershëm të Regjimit të Posaçëm të Ndalimit pas shkeljes, ndërsa Neni 41-bis kërkon një vlerësim konkret të çështjes së individit dhe nëse masa është e nevojshme të ushtrohet, duke pasur parasysh rrethanat specifike të secilës çështje individuale.

Nga mënyra se si është shkruar, Neni i propozuar 13/1 parashikon zbatimin e menjëhershëm të Regjimit të Posaçëm dhe pa një vlerësim konkret, vlerëson rrethanat që e lidhin individin në mënyrë të drejtpërdrejtë me krimin. Ministri i Drejtësisë mundet t'i jap fund zbatimit të Regjimit të Posaçëm vetëm pas një kërkesë të bërë nga i pandehuri, dhe pasi personi të ketë kaluar tashmë një vit në një regjim të Posaçëm.

Neni 41-bis i mundëson Ministrit të Drejtësisë, me anë të kërkesës së Ministrit të Brendshëm, të pezullojë rregullime të caktuara në burg dhe të zbatojë Regjimin e Posaçëm në raste përjashtimore kur ka elementë konkretë dhe specifikë, të cilët konfirmojnë lidhjen e individit me mafien ose organizatat terroriste dhe e arsyeton zbatimin e Regjimit të Posaçëm si absolutisht të nevojshme për të garantuar rendin dhe sigurinë. Një gjë e tillë konfirmon natyrën përjashtimore të masave, sepse vendimi i Ministrit të Drejtësisë merret për nevoja konkrete për pezullimin e disa prej rregullave të praktikës normale të burgimit për të garantuar rendin dhe sigurinë në interes të luftës kundër krimit të organizuar.

Në vijim të diskutimeve, Komisioni për Sigurinë Kombëtare vlerësoi ndërmarrjen e kësaj nisme ligjore dhe propozoi disa reformulime si më poshtë vijon:

III. RIFORMULIME NEN PËR NEN

Neni 13/1 të riformulohet si më poshtë:

1. Të dënuarit në burgun e sigurisë së lartë dhe të paraburgosurit që hetohen apo gjykohen për veprat penale të parashikuara në nenet 230, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 231, 232, 232/a, 234, 234/a, 234/b, 283 paragrafi 3, 283/a paragrafi 3, 284/a, 284/c paragrafi 3, 284/ç paragrafi 3, 287, 333, 333/a dhe 334 të Kodit Penal, të kryera në kuadër të pjesëmarrjes në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë të armatosur, organizatë terroriste apo për vepra me qëllime terroriste, mund të vendosen në një regjim të posaçëm të ushtrimit të të drejtave.

2. Vendosja e regjimit të posaçëm të ushtrimit të të drejtave në burgun e sigurisë së lartë bazohet vetëm në ruajtjen e rendit dhe të sigurisë dhe/ose parandalimin e komunikimit të të dënuarit ose të paraburgosurit me organizatën kriminale ku bëjnë pjesë apo me organizata të tjera, të referuara në pikën 1 të këtij neni. Kohëzgjatja e regjimit të posaçëm të ushtrimit të të drejtave në burgun e sigurisë së lartë, lidhet ngushtë me arritjen e qëllimeve të përmendura në këtë pikë.

3. Vendimi për regjimin e posaçëm të ushtrimit të të drejtave, merret nga Ministri i Drejtësisë, në bazë të propozimit të arsyetuar të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, pas konsultimit me Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Burgjeve.

4. Regjimi i posaçëm i ushtrimit të të drejtave konsiston në:

a) masa të brendshme dhe të jashtme të sigurisë së lartë që lidhen kryesisht me nevojën për të parandaluar;

i. kontaktet me organizatën kriminale ku bëjnë pjesë apo me organizata të tjera, me të cilat ata bashkëpunojnë;

ii. konfliktet e mundshme me elementë të organizatave kundërshtarë;

iii. ndërveprimin me të burgosurit apo të paraburgosurit e tjerë, të cilët i përkasin së njëjtës organizatë ose të organizatave të tjera, me të cilat ata bashkëpunojnë;

iv. komunikimin apo shkëmbimin e sendeve ndërmjet të dënuarve apo të paraburgosurve që i përkasin grupeve të ndryshme.

b) lejimin e një takimi familjar në muaj, i cili kryhet në intervale të rregullta kohore dhe në mjedise të caktuara, ku ndalohej hyrja e personave apo sendeve të tjera dhe që i nënshtrohen regjistrimit audio dhe video. Me termin “familjarë” nënkuptohen të paralindurit, të paslindurit, bashkëshortët dhe bashkëjetuesit. Në raste të jashtëzakonshme, takimi me persona të ndryshëm nga familjarët, për personat e dënuar,

kryhet me propozimin e drejtorit të institucionit dhe me miratimin e Ministrit të Drejtësisë. Për personat e paraburgosur, takimi me persona të ndryshëm nga familjarët kryhet vetëm me miratimin e prokurorit. Parashikimet e këtij paragrafi nuk zbatohen për takimet me avokatët mbrojtës;

c) lejimin e të dënuarit ose të paraburgosurit, i cili nuk kryen takime familjare, për kryerjen një bisede telefonike në muaj, me kohëzgjatje maksimale dhjetë minuta, e cila regjistrohet. Kryerja e bisedave telefonike për personat e dënuar autorizohet me vendim të arsyetuar të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, kurse, për personat e paraburgosur, ajo autorizohet me vendim të arsyetuar të prokurorit;

ç) ndalimin e përdorimit të vlerave monetare, sendeve dhe objekteve që mund të marrë i dënuari ose i paraburgosuri nga jashtë, sipas parashikimeve në rregulloren e brendshme të institucionit;

d) kontrollin e korrespondencës, përveç asaj me subjektet e përcaktuara në nenin 43, të këtij ligji, ose me organizata ndërkombëtare, që ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut;

dh) reduktimin e qëndrimit në ajrim në mjedise të hapura, por jo më pak se 1 orë në ditë;

e) përjashtimin nga organet përfaqësuese të të dënuarve apo të paraburgosurve.

5. Ministri i Drejtësisë, pas një periudhe një vjeçare, rivlerëson nëse janë kushtet për vazhdimin e regjimit të posaçëm të ushtrimit të të drejtave ndaj të dënuarve ose të paraburgosurve të vendosur në një regjim të tillë. Për marrjen e vendimit, Ministri i Drejtësisë merr paraprakisht mendimin e prokurorit, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit si dhe të gjitha të dhënat e tjera të nevojshme nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, organet e Policisë së Shtetit dhe atyre të specializuara në luftën kundër krimit të organizuar e terrorizmit, sipas fushave të përgjegjësisë.

Ministri i Drejtësisë vendos zgjatjen e afatit për periudha të tjera njëvjeçare të ushtrimit të regjimit të posaçëm ndaj të dënuarit ose të paraburgosurit, kur ekzistojnë ende rrethana lidhur me:

a) aftësinë e të dënuarit për të mbajtur lidhje me organizatën kriminale apo terroriste, duke marrë në konsideratë edhe profilin kriminal dhe rolin e subjektit brenda organizatës, si dhe vazhdimin e veprimtarisë së bashkëpunimit kriminal;

b) ekzistencën e akuzave të reja, të pa vlerësuar më parë;

c) rezultatit e trajtimit penitenciar si dhe të standardit të jetesës së anëtarëve të familjes së subjektit.

Kalimi i kohës nuk përbën, në vetvete, një element të mjaftueshëm për të përjashtuar aftësinë e të dënuarit në regjim të posaçëm për të mbajtur lidhjet me organizatën apo për të provuar mungesën e operativitetit të saj.

6. Kundër vendimit të Ministrit të Drejtësisë, i cili ka vendosur zgjatjen e regjimit të posaçëm, i dënuari, i paraburgosuri ose mbrojtësi i tij, kanë të drejte të paraqesin ankim brenda 20 ditëve, nga momenti i njoftimit të vendimit.

7. Ankimi depozitohet në gjykatën e rrethit gjyqësor kompetente për gjykimin e çështjes sipas parashikimit të nenit 470 të Kodit të Procedurës Penale. Gjykata procedon sipas mënyrës së parashikuar në nenin 471 të Kodit të Procedurës Penale. Gjykimi i çështjes nuk pezullon vendimin e Ministrit të Drejtësisë.

8. Në qoftë se ankimi kundër vendimit të Ministrit të Drejtësisë pranohet nga ana e gjykatës, Ministri i Drejtësisë, në rast se do të urdhërojë një vendim të ri, duhet të mbajë parasysh përcaktimet e bëra në vendimin e gjykatës, duke shtuar elemente të rinj që nuk janë vlerësuar ose nuk njiheshin më parë. Edhe ndaj këtij vendim i ri mund të ushtrohet ankim sipas përcaktimit në pikën 6 të këtij neni.

IV. KONKLUSIONE

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni për Sigurinë Kombëtare, me shumicën e anëtarëve miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi.

Relator

Kryetar

Pjerin Ndreu

Ermonela (Felaj) VALIKAJ